



Mirë se vini në Moosseedorf !

**Broshurë informative për
banoret dhe banorët imigrantë**

**Administrata Komunale, Moosseedorf
2011**

Përmbajtja

1. Plani i Komunës
2. Gjermanisht / Ndimë për përkthime
3. Adresat e rëndësishme
Emergjenca
Zyrat e ndryshme
Mjekët
Dentisti
Institucionet sociale
Të ndryshme
4. Sigurimet
AHV (Sigurimi i pleqërisë, i pasardhësve dhe ai invalidorë)
Sigurimi shëndetsorë dhe kundër aksidenteve
Sigurimi i papunsësisë
Sigurimi i pajisjeve shtëpijake dhe i përgjegjesisë private
5. Banimi
Kërkimi i banesave
Zhurma
Problemet me qiradhënësin dhe fqinjët
6. Shëndeti
Mjekët
Barnatoret
Spitalet
Përkujdesja në shtëpi (Spitex)
Këshillimorja për prindërit
Shtëpia e grave në Bern
„Lantana“
7. Fëmijët dhe të rinjtë
Shkolla dhe kopshti i fëmijëve
Përkujdesja për fëmijët
Këshillimoret
8. Koha e lirë / kultura
Plazhi në Moossee
Shkolla e muzikës Moossee
„JUKA“ pikëtakimi i të rinjëve
Pikëtakimi interkulturore i grave „KARIBU“
„Café Maxi Bébé“
Biblioteka Urtenen-Schönbühl
Shoqatat
9. Heqja e mbeturinave

Mirë se vini në Moosseedorf !


Ju vini nga një vend i jashtëm dhe tani jetoni në Moosseedorf. Shumë gjëra për ju do të jenë të reja, disa të pazakonshme apo të panjohura. Ne duam që ju të ndiheni mirë në komunën tonë.

Kjo broshurë informative do të ju ndihmojë që të orientoheni në Moosseedorf dhe që të integroheni sa më mirë. Në faqet që vijojnë do të gjeni informata, adresa dhe numra telefonash. Drejtohuni me pyetjet tuaja në adresat përkatëse dhe shfrytëzoni ofertat e shumta që i keni në dispozicion.

Ne ju dëshirojmë një fillim të mbarë

Këshilli i Komunës Moosseedorf

Plani komunës:



Legjenda:

- 1 Administrata Komunale
- 2 Qendra shkollore Staffel
- 3 Komuna Kishtare
- 4 Sekretariati i të rinjëve
- 5 Posta
- 6 Kopshti i fëmijëve
- 7 Kisha

2. Gjermanisht / Ndhmë për përkthime

Në Zvicër janë gjuha e shkruar dhe ajo e folur krejtësisht të ndryshme. Për dallim nga gjuha e shkruar, ka shumë dialekte të ndryshme. Dielekti në Moosseedorf quhet „Berndojç“. Si për gjermanisht ashtu edhe për „berndojç“ ofrohen kurse gjuhësore për fillestare dhe fillestarë

Qendra informative për migrantet dhe migrantët „isa“ ofron informata në telefon apo edhe personalisht, në gjuhë të ndryshme.

„isa“ organizon **edhe kurse të gjermanishtes për të rritur si dhe për fëmijët dhe prindërit me moton: „Fëmija im mëson gjermanisht, unë mësoj gjithashtu“.**

Qendra informative për çështje të migrianteve „isa“

Bollwerk 39, 3011 Bern

Tel. 031 310 12 70

www.isabern.ch

Orari i punës: E hënë deri të premten 9.30 Orë – 12.30 Orë,(përveç e hënë) 14.00 Orë – 16.00 Orë.(përveç e premte)

3. Adresa të rëndësishme

3.1 Numrat e emergjencës

Policia	117
Zjarrfikësit	118
Ambulanca	144
Mjeku i emergjencës	0900 57 67 47
Rega	1414
Aksidentet me helme	145

3.2 Institucionet

Administrata komunale
Kontrolli i banorëve dhe të huajve
Zyra e gjësendeve të gjetura
Zyra e tatimeve
Dega e sigurimit të pleqërisë AHV
ndërtimit

Schulhausstrasse 1
www.moosseedorf.ch

031 850 13 13

Policia

Zentrumsplatz 9
3322 Urtenen-Schönbühl

031 368 72 01

Zyra e gjendjes civile

Zivilstandskreis Bern-Mittelland
Laupenstrasse 18a
3008 Bern

031 635 42 00

Drejtoria e përmbarimit dhe e
Falimentimit

Dienststelle Mittelland
Poststrasse 25
3072 Ostermundigen

031 635 92 00

Posta

Kirchgasse 5

031 859 01 04

3.3 Mjekët

Dr. Liselotte Hochuli

Moosbühlstrasse 2

031 852 00 10

Dr. Dominik Weiss

Badweg 7

031 859 22 85

Dr. H. Mauron

Moosbühlstrasse 33

031 859 33 85

3.4 Dentisti

Dr. Wilhelm Schär

Schulhausstrasse 13

031 859 46 46

3.5 Institucionet Sociale

Qendra për punë sociale

Fellenbergstrasse 9
3053 Münchenbuchsee

031 868 38 38

Shtëpia e pleqëve „Weiermatt“

Moosgasse 15

	3053 Münchenbuchsee	031 868 30 60
Betax, shërbimi i transportit për invalidë dhe pleqë		031 990 30 90
Spitex	Kirchgasse 9 3053 Münchenbuchsee	031 850 20 80
Sekretariati i shkollës	Shkolla Staffel 1 Schulhausstrasse 23	031 850 10 70
Sekretariati i të rinjëve	Moosstrasse 4	031 859 36 76
Këshillimorja kantonale për edukim	Effingerstr. 12 3011 Bern	031 633 41 41
Këshillimorja për profesione	Bremgartenstrasse 37 3007 Bern	031 633 80 00
„Contact“ Këshillimorja për problemet me drogën	Eigerstrasse 80 3000 Bern	031 378 22 22
Këshillimorja për prindërit	Bernstrasse 28 A 3303 Jegenstorf	031 762 06 70
Qerdhja e fëmijëve „Moskito“	Längenbühlstrasse 14	031 859 57 36
Grupi i lojërave	Christine Seemann Sandstrasse 12	031 859 95 80
	Doris Gygax Moosbühlstrasse 39	031 859 65 71

3.6 Të ndryshme

Zyrtarja për varrime	Ruth Egli Sandstrasse 3	031 859 66 18
Kishat / shtëpitë e kultit:	Kisha e reformuar Moosseedorf	031 859 79 35
	Kisha Romake-katolike Kirchgemeinde Zollikofen	031 910 44 09
	Qendra Islame në Bern Lindenrain 2A, 3012 Bern	031 302 62 91
	Tempulli Murugen Bahnstrasse 21, 3008 Bern	031 381 45 22

4. Sigurimet

4.1 AHV (Sigurimi i pleqërisë, i pasardhësve dhe invalidor)

Të gjithë personat e rritur që banojnë ose punojnë në Zvicër janë detyrimisht të siguruar tek AHV dhe duhet të paguanë kontributet. Atyre që marrin rrogë, u ndalen kontributet nga rroga. Të papunësuarit duhet t'i paguajnë vet kontributet dhe mbajnë vetë përgjegjësinë. Për informata më të hollësishme drejtohuni në vendin e punës apo tek zyra e AHV-së në Moosseedorf. 031 850 13 13

4.2 Sigurimi për sëmundje dhe aksidente

Çdo person në Zvicër është i detyruar të jetë i siguruar tek një arkë e sigurimeve shëndetsore („Krankenkasse“). Çdo anëtarë i familjes duhet të jetë individualisht i siguruar. Informohuni tek punëdhënësja/punëdhënësi juaj se si jeni të siguruar në rast sëmundje apo aksidenti.

4.3 Sigurimi i papunësisë

Personat që marrin rrogë, paguajnë automatikisht kontributet në arkën e të papunëve („ALV“). Këto kontribute u ndalen drejtpërdrejtë nga rroga. Nëse jeni i papunë apo me rastin e pezullimit nga puna, lajmërohuni në administratën komunale. Për paraqitje duhet sjellur: Letërnjoftimin për të huaj dhe kartën AHV. Ndërmjetësimi për punësim, këshillimi dhe kontrolli për sigurimin e papunësisë bëhen nga Qendra regjioale e ndërmjetësimit për punësim (RAV) në Zollikofen.

Administrata komunale

031 850 13 13

4.4 Sigurimi i paisjeve shtëpiake dhe i përgjegjësisë private

Kur merrni banesë me qira, duhet të kontraktoni sigurimin për paisjet shtëpiake. Ky sigurim i mbulon dëmet eventuale të shkaktuara nga zjarri, uji, fatkeqësitë natyrore dhe, pjesërisht nga vjedhja. Ky sigurim është i detyrueshëm.

Sigurimi i përgjegjësisë private i mbulon dëmet të cilat ju, padashje, ua shkoktoni personave të tretë. Ky sigurim nuk është i detyrueshëm por shpeshherë është i dobishëm.

Sigurimet përkatëse mund t'i kontraktoni pothuajse tek të gjitha kompanitë e sigurimeve.

5. Banimi

5.1 Si të gjej banesë

Banesat e lira nuk gjenden lehtë. Atyre që kërkojnë banesë ua preferojmë shpalljet për banesa në gazetatat ditore, në “Fraubrunner Anzeiger” dhe në “Grauholz-Post”.

5.2 Zhurma

Zhurma, shpeshherë është shkak i tensioneve dhe zënkave në mes të fqinjëve. Ju lutemi, veni re rregullat në vijim:

- Punët e zhurmëshme (me çekan apo me makina të ndryshme) lejohen vetëm gjatë ditëve të punës dhe të shtunave prej 07.00-12.00 dhe prej 13.00-20.00.
- Prej orës 12.00 - 13.00 është pushimi i drekës.
- Evitoheni zhurmën me Automjet: mos e lini motorin ndezur pa nevojë, mos i bini burisë, dyert e automobilin dhe të garazhës mbyllni ngadalë, pa zhurmë.
- Respektojeni qetësinë e natës prej orës 22.00. Prej orës 22.00 nuk guxon të bëhet zhurmë pa nevojë: Radio, Televizori, dhe aparatet muzikore mund të përdoren me zë që dëgjohet vetëm në dhomë. Fëmijët, të rinjtë por edhe të rriturit nuk bën të argëtohen jashtë, me zë të lartë.
- Evitoheni muzikën me zë të lartë, në hapësirë të hapur, me dritare të hapura apo në balkon si dhe hyrjet dhe daljet e zhurmëshme në korridor.
- Informojini fqinjët nëse luani në ndonjë instrument apo festoni me familjen apo me miqtë.
- Respektojeni qetësinë e së dielës.
- Respektojeni rendin shtëpijak të ndërtesës ku banoni!

5.3 Problemet me Qiradhënësin dhe me fqinjët

Nëse keni probleme me qiradhënësin apo me fqinjët ose u duhen këshilla juridike për çështjet e banimit, drejtohuni në zyrën e qiraxhinjëve (Mietamt) në Komunë.

Schlichtungsbehörde
Bern-Mittelland

Effingerstrasse 34
3008 Bern

031 635 47 50

6. Shëndetësia

6.1 Mjekët

Në Moosseedorf kemi tre mjekë dhe një dentist. Adresat dhe numrat e telefonit mund t'i gjeni nën „Adresa të rëndësishme“. Në Zvicër, shumica e ordinancave mjekësore janë të enjten pasdite, në mbrëmje dhe natën si dhe të shtunave dhe të dielave mbyllur. Në raste urgjente thirrni numrin e poshtëshënuar

Shërbimi i urgjencës mjekësore

0900 57 67 47

6.2 Barnatoret

Barnatoret i gjeni në „Shopyland“, në Urtenen-Schönbühl, në Zollikofen dhe në Münchenbuchsee. Më në qendër është barnatorja në stacionin qendror të trenit në Bern, kati i dytë. Barnatorja në stacionin e trenit punon çdo ditë prej 06:30 deri në orën 22.00.

031 329 25 25

6.3 Spitalet

Inselspital në Bern

031 632 21 11

Spitali i fëmijëve në Bern

031 632 21 11

Tiefenauspital në Bern

031 308 81 11

Poliklinika psikiatrike në Inselspital

031 632 21 11

6.4 Spitex

Spitex-i është një institucion që përkujdeset për të sëmurët në shtëpi. Pyetjet që kanë të bëjnë me shëndetin, përkujdesjen dhe ndihmën për përballimin e përditshmërisë pas sëmundjes apo aksidentit mund t'i bëni çdo ditë.

Orari i punës:

Nga e hëna deri të premten, 08.00 – 12.00, 14.00 – 17.00

031 850 20 85

6.5 Këshillimorja për prindërit

Këshillimorja për prindërit ndihmon në përkujdesjen dhe ushqimin e foshnjeve dhe fëmijëve të vegjël.

Këshillat telefonike: Prej të hënës deri të premten prej 8.00- 9.30

031 762 06 70

Këshillat në komunën e kishës në Moosseedorf të hënën e 2 dhe të 4 të muajit prej 14.00 – 16.00

Këshillat janë falas.

6.6 Shtëpia e grave në Bern

Strehim dhe këshillim për gratë e keqtrajtuara dhe fëmijët e tyre.

031 332 55 33

6.7 Lantana

Ndihmë për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe të keqtrajtuara

031 313 14 00

7. Fëmijët dhe të rinjtë

7.1 Shkolla dhe kopshti i fëmijëve

Parimore

Vijimi i shkollës popullore është i obligueshëm për fëmijët e moshës 7 deri në 15 vjeçare. Mësimi gjatë kohës së shkollimit të obligueshëm është pa pagesë. Materialet shkollore dhe librat u ipen fëmijëve falas. Shkolla publike është, në aspektin konfesional, neutrale. Vajzat dhe djemtë mësojnë së bashku.

Fillimi i shkollimit

Çdo fëmijë i cili, para 1 majit e arrinë moshën gjashtë vjeçare, në fillim të vitit shkollorë në vijim është obligues i shkollës. Viti shkollor fillon në gusht, pas pushimeve verore.

Kohëzgjatja e shkollimit të obliguar është 9 vjet.

Fëmijët imigrantë që vijnë në Zvicër, nëse e dëshmojnë se kanë kryer shkollën e obligueshme, si dhe i kanë mbushur 15 vjet, nuk janë më të detyruar të vijnë në shkollimin.

Regjistrimi në shkollë

Prindërit duhet t'i paraqesin fëmijët e tyre për regjistrim në sekretariatit e shkollës:

Sekretariati i shkollës, Shkolla Staffel I, Schulhausstrasse 23 031 850 10 70

Orari i punës: Të mërkurën dhe të enjten prej 08.30 deri në orën 11.30.

Vijimi i mësimi

Prindërit janë të obliguar t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, rregullisht dhe me kohë.

Kush nuk e dërgon fëmijën e vet në shkollë, mund të dënohet.

Prindërit duhet ta njoftojnë mësuesen/mësuesin nëse fëmija i tyre, për shkak të sëmundjes apo kontrollit mjekësorë, nuk mund të shkojë në shkollë.

Fëmija ka të drejtë, në çdo vit shkollor, të marrë 5 herë nga një gjysmë dite të lirë. Këto 5 gjysmëdite nuk mund të merren drejtpërdrejtë para ose pas pushimit, për ta zgjatur atë. Arësimtarja/arësimtari e/i klasës duhet të informohet nga prindërit.

Kontakti shkollë-prindër

Për informata rreth shkollës, planit mësimor apo në rast të problemeve speciale drejtohuni tek mësimdhënësja/mësimdhënësi kujdestar. Nëse në këtë rrugë nuk gjendet zgjidhja, atëherë duhet kontaktuar drejtorinë ose komisionin e shkollës.

Informata të rëndësishme që i përkasin shkollës, publikohen në mënyrë periodike në buletin „Anzeiger Fraubrunnen“ në „Am moossee“ dhe në „Staffelpost“ (Gazetë e shkollës).

Kopshti i fëmijëve

Vijimi në kopshtin e fëmijëve në Kantonin e Bernës është vullnetar. Në Moosseedorf, kopshtin e fëmijëve mund ta vijnë fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeçare. Për këtë ata duhet të paraqiten në sekretariatit e shkollës. Për fëmijët e paraqitur, vijimi është i obligueshëm.

Vijimin në kopshtin e fëmijëve ua preferojmë të gjithë fëmijëve. Aty i mësojnë, përmes lojës, raportet me bashkmoshatarët, gjuhën si dhe rregullat kryesore për fillim të mbarë në shkollë. Aty stimulohet aftësimi mental dhe emocional i fëmijëve. Vijimi në kopshtin e fëmijëve ia shton fëmijës në masë të madhe gjasët për integrim.

Për informata më të hollësishme, ju lutemi drejtohuni në sekretariatit e shkollës.

Numrat më të rëndësishëm telefonik të shkollës dhe të kopshtit të fëmijëve

Sekretariati i shkollës	031 850 10 70
Shkolla Staffel II	031 850 10 75
Shkolla Staffel III	031 850 10 85
Kopshti i fëmijëve „Altes Schulhaus“	031 859 25 48
Kopshti i fëmijëve „Längenbühlstrasse“	031 859 29 45
Kopshti i fëmijëve „Eichenstrasse“	031 859 34 60

Në administratën komunale mund ta merrni listën aktuale të anëtarëve të komisionit të shkollës dhe të përfaqësuesve të prindërve.

7.2 Përkujdesja për fëmijët

Çerdhja për strehimin ditore të fëmijëve

„KITA Moskito“ është një çerdhe fëmijësh, e cila i pranon fëmijët prej moshës gjashtë muajshe deri në moshën shkollore dhe ofron përkujdesje dhe ushqim për ta. „KITA Moskito“ ofron mundësi të ndryshme të përkujdesjes. Lartësia e çmimit për përkujdesje caktohet në bazë të të ardhurave të prindërve.

KITA Moskito
Längenbühlstrasse 14, 3302 Moosseedorf 031 859 57 36

Grupi i lojërave (“Spielgruppe”)

Shoqata e prindërve në Moosseedorf, për fëmijët prej moshës trevjeçare deri në moshën gjashtëvjeçare, e administron grupin e lojërave. Pranimi i fëmijëve bëhet çdo gjysëm viti.

Adresa kontaktuese:
Frau Christine Seemann, Sandstrasse 12 031 859 95 80

Shkolla ditore

Në kuadër të shkollës së Moosseedorf-it funksionon edhe shkolla ditore. Nxënësit aty janë nën përkujdesje, mund të hanë drekë dhe u ofrohet ndihmë në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë.

Shkolla ditore në Moosseedorf udhëhiqet nga një profesionist me pregaditje shkollore pedagogjike. Çmimi edhe për shkollën ditore caktohet në bazë të të ardhurave të prindërve.

Për pyetje dhe regjistrim kontaktoni Dita e shkollës 031 850 10 77

7.3 Këshillimoret

Sekretariati i të rinjve i përkrahë, i stimulon dhe i këshillon fëmijët, të rinjtë dhe kujdestarët e tyre. Aty ofrohen këshillime, informacione dhe animacion në lëminë e aktiviteteve të lira. Punëtorët e sekretariatit të të rinjve bashkëpunojnë me shkollën dhe me

kishën në realizimin e projekteve parandaluese. Në raste të veçanta ndihmojnë edhe në kërkimin e vendeve të punës apo të mësimi. Sekretariati i të rinjëve është në kuadër sekretariatit regional të punës me fëmijë dhe të rinjë të komunave Moosseedorf, Urtenen-Schönbühl dhe Jegenstorf.

Kontaktoni: Jugendsekretariat
Moosstrasse 4, 3302 Moosseedorf
www.rekja.ch

031 859 36 76

Në rast të problemeve në **shkollë** dhe/apo në çështjet rreth **edukimit** drejtohuni në Këshillimoren Kantonale për Edukim në Bern („Kantonale Erziehungsberatung Bern“. Ky institucion është kompetent për të gjitha çështjet shkollë-psikologjike. Këshillimet janë falas.

Për paraqitje në rast të problemeve në shkollë, nevojitet raporti me shkrim i personelit mësimdhënës.

Kant. Erziehungsberatung Bern
Effingerstrasse 12, 3011 Bern
www.erz.be.ch/erziehungsberatung

031 633 85 11

Këshillimorja për profesionet ju ndihmon të rinjëve të rritur për t'i analizuar interesat dhe aftësitë e tyre. Këshillimet dhe informatat janë falas.

Berufsberatung BIZ Bern-Mittelland
Bremgartenstrasse 37, 3007 Bern
www.erz.be.ch/berufsberatung

031 633 80 00

Në rast të problemeve me **Drogën**, të rinjëve apo prindërve të tyre mund t'u ofrohen këshilla dhe ndihmë në adresën:

Contact Bern,
Monbijoustrasse 70, Postfach, 3000 Bern 23
www.contactnetz.ch

031 378 22 22

Njerëzve që kanë probleme me alkoolin, me medikamentet si dhe ata me varshmëri bixhozi u ofrohen këshilla tek:

Berner Gesundheit
Eigerstrasse 80, 3000 Bern 23
www.beges.ch

031 370 70 70

Për pyetje dhe informata rreth racizmit dhe dhunës apo atakimeve raciste drejtohuni në: **gggfon („Gemeinsam gegen Gewalt und Rassismus“)** (Së bashku kundër dhunës dhe racizmit)
www.gggfon.ch

031 333 30 40

8. Koha e lirë / Kultura

8.1 Plazhi në Moossee

Plazhi në Moossee është prej majit deri në shtator i hapur. Banorët e Moosseedorf-it mund t'i marrin tiketat e abonimit me çmim të reduktuar, prej muajit prill, në Administratën Komunale. Ndërkaq nxënësve u ipen në shkollë tiketat e abonimit falas.

8.2 Shkolla e muzikës „Moossee“

Shkolla e muzikës ofron mësim në lëndët instrumentale, vokale, ritëm dhe në valle për fëmijë, të rinjë dhe për të rritur. Varësisht nga lënda, mund të zhvillohet mësimi në grupe apo edhe individualisht. Mësimi në shkollën e muzikës është me pagesë.

Sekretariati i Shkollës së Muzikës „Moossee“
Unterdorfstrasse 7, 3322 Urtenen-Schönbühl
www.musikschule-moossee.ch

031 859 60 16

8.3 „JUKA“ Pikëtakimi i të rinjëve

Në komunën e kishës në Moosseedorf gjendet një pikëtakimi e të rinjëve. Aty është një kënd për „tavolinë futbollit“, një sallë vallëzimi, ulëse ku mund të bisedohet dhe mund të dëgjohet muzikë si dhe një bar me pije joalkoolike.

8.4 Pikëtakimi interkulturorë i grave „KARIBU“

KARIBU është një pikëtakimi ku ofrohen kurse gjuhësh, kurse rrobaqepësie si dhe informacione të vlefshme për përditshmërinë, për të gjitha gratë migrante. Përkujdesja për fëmijët është e siguar, ata mund edhe të marrin pjesë në mësim. Gratë nga Moosseedorf-i janë të mirëseardhura!

KARIBU
Schäferestrasse 43, 3052 Zollikofen

031 911 65 25

8.5 Café Maxi Bébé

Të hënën e dytë dhe të katërt të muajit, gjatë këshillimeve të prindërve, është Café Maxi Bébé e hapur. Ju mund të uleni aty para ose pas këshillimeve, të pini një kafe dhe të shkëmbeni mendime me prindërit tjerë. Fëmijët mund të luajnë së bashku.

8.6 Biblioteka Urtenen-Schönbühl

Biblioteka Urtenen-Schönbühl ka një fond të pasur librash, disqesh (CD), DVD, dhe shiritash. Këto huazohen me një qmim shumë të ulët. Nxënësit mund ta shfrytëzojnë bibliotekën falas.

Biblioteka Urtenen-Schönbühl
Zentrumsplatz 8, 3322 Urtenen-Schönbühl

031 859 26 27

8.7 Shoqatat

Në Moosseedorf ka shumë shoqata. Ato kanë një funksion shumë të rëndësishëm për bashkëjetesën. Ato kontribuojnë në përmbushjen kuptimplote të kohës së lirë dhe i tubojnë bashkëvendimtarët. Ja disa shembuj:

- Klubi i futbollit në Schönbühl (www.fcschoenbuehl.ch)
- Klubi i hokejit në Münchenbuchsee-Moosseedorf (www.hcm-m.ch)
- Klubi Unihockey (www.hornets.ch)
- Klubi i hendbollit (www.grauholz.ch)
- Klubi i basketbollit në Moosseedorf (www.kbc-moosseedorf.ch)
- Klubi i ping-pongut në Moosseedorf (www.ttc-regio-moossee.ch)
- Klubi i fiskulturës Moosseedorf
- Klubi i fiskulturës (për femra) Moosseedorf
- Grupi teator në Moosseedorf (www.theatergruppe86.ch)
- Alpinistët Schekka, Urtenen-Schönbühl (www.pfadischekka.ch) oder Alpinistët St. Franziskus Zollikofen (www.pfadi.ch/frisco)
- Shoqata e kopshteve familjare
- Moossee „Gospel“- këngëtarët

Një listë të plotë të shoqatave mund ta gjeni në www.moosseedorf.ch ose në regjistrin zyrtar të cilin mund ta merrni në Administratën Komunale.

Anëtarët e rinjë janë gjithnjë të mirëseardhur në të gjitha shoqatat!



9. Heqja e bërlllogut në Moosseedorf

Në Moosseedorf duhet paguar për heqjen e bërlllogut. Mbeturinat e amvisnive seleksionohen nga vetë banorët, në mënyrë që të mund të heqen ndaras.

Bërlllogu shtëpiak që mund të digjet, bën të hudhet vetëm në thasë me taksë, madhësishë të ndryshme. Thasët me taksë mund të blehen e në Denner, Sandstrasse dhe në Migros Shoppyland. Mbeturinat që mund të digjen, duhet hedhur vetëm me thasët oficiel të bërlllogut.

Për bërlllogun që nuk e zë thesi, komuna shet tiketën që mund të ngjitet në gjësende. Ato duhet të lidhen, të bëhen gati për transport.

Bërlllogu bartet të mërkurën në mëngjes. Thasët mund të nxirren të martën në mbrëmje në vendin e caktuar.

Mbeturinat e gjelbërta nga kuzhina dhe kopshti hudhen në konteinerin special për mbeturina të gjelbërta për t'u përpunuar më vonë si pleh për kopshte. Ju lutemi, mos hudhni gjësende plastike, najlloni apo mbeturina të ushqimit në konteinerin e „gjelbërt“!

Gazetat, letrat e vjetra dhe kartoni tubohen në shtëpi, bëhen deng dhe lidhen. Gazetat e vjetra dhe kartoni mblidhen 5 herë në vit dhe dërgohen në ripërpunim. Letrat dhe kartoni duhet të lidhen ndaras. Thasët e mbushur me letër dhe karton **nuk** merren

Xhamat, dozat e konzervave, alumini dhe shishet „pet“ nuk heqen me mbeturinat që digjen. Për këto ka konteinerë specialë dhe vende grumbullimi.

„Werkhof“	Alumini dhe llamarina e bardhë (konzervat dhe kutitë) Xhamat e vjetër, Rrobat e vjetra, vaji i përdorur, Kemikaliet
Shitorja e fshatit	Shishet „Pet“
Shoppyland	Shishet „Pet“, Xhamat e vjetër
Hofwilstrasse 1	Xhamat e vjetër dhe rrobat e vjetra

Në administratën komunale mund ta merrni një broshurë informative rreth heqjes së bërlllogut dhe mbeturinave. Ju ndihmon shumë dhe I përmbanë të gjitha datat e heqjes së bërlllogut.